

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Procedura që ndiqet për kundërshtimin në apel të vendimit të Speciales
ADRESA	https://albeu.com/kosove/procedura-qe-ndiqet-per-kundershtimin-ne-apel-te-vendimit-te-speciales/1014804/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 17:01:48 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 17:00:21 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c2bf6d61f23cc276eb178eaf9cc09a0c0d76e8f7ed8ba17bc83ca3c340d005bb
TEKSTI	bb0a3c47b68537f1c0a04dbbc0cfa23ccd7b686109a5ff990d6fe3ae0b5416ea
PAMJA	fb99656c1340bccf9d7a7953d0e7f7624acdf3b10bafd8db8b2fba11a389c261

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a435cf7ca675c60f42101190033e1c6287803f686cf3b43bd7f447ba69f86f1f
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9515102868483048fab913125dfd13516db18986db3bd96a2369642ebf1c0d96
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a435cf7ca675c60f42101190033e1c6287803f686cf3b43bd7f447ba69f86f1f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Procedura që ndiqet për kundërshtimin në apel të vendimit të Speciales



Mbrojtja e ish-eporëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka bërë të ditur se do ta kundërshtojë në apel aktgjykimin dënues, të cilin trupi gjyqësor i Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë e shpalli më 16 shtator.

Sipas këtij vendimi, Hashim Thaçi dhe Jakup Krasniqi u dënuan me nga 25 vjet burgim për katër pika të aktakuzës. Kadri Veseli u shqiptua dënimi me 18 vjet burgim, ndërsa Rexhep Selimi u dënua me 13 vjet.

Katër ish-eporët e UÇK-së u gjetën penalisht përgjegjës për krime lufte, përfshirë ndalimin e paligjshëm ose arbitrar, trajtimin mizor, torturën dhe vrasjen e paligjshme. Në të njëjtin aktgjykim, trupi gjyqësor hodhi poshtë pretendimet e Zyrës së Prokurorit të Specializuar për krime kundër njerëzimit.

Thaçi, Krasniqi, Veseli dhe Selimi ndodhen në paraburgim në Hagë që prej nëntorit të vitit 2020.

Aktgjykimi mund të kundërshtohet nga të dyja palët. Mbrojtja ka të drejtë të kërkojë anulimin e plotë të tij ose uljen e dënimeve për pika të caktuara të aktakuzës, ndërsa Zyra e Prokurorit të Specializuar mund të synojë shqiptimin e dënimeve më të ashpra.

ZPS-ja e përshëndeti vendimin dënues, por njoftoi se do ta analizojë tërësisht aktgjykimin, duke përfshirë edhe pjesën me të cilën u rrëzuan akuzat për krime kundër njerëzimit.

Procedura e apelit zhvillohet përmes disa hapave dhe afateve të përcaktuara.

Rregullorja e Procedurës dhe Provave përcakton se pala që kundërshton vendimin e gjykatës, dënimin ose të dyja, duhet të paraqesë njoftimin për apel brenda 30 ditësh nga shpallja e aktgjykimit. Në këtë dokument duhet të renditen shkaqet mbi të cilat mbështetet ankesa.

Pas kësaj, kryegjykatësi i panelit të Gjykatës së Apelit, i përbërë nga tre anëtarë, mund të emërojë njërin prej nivakatëve si raportues për fazën paraapeli. Detyra e tij është të trajtojë aspektet procedurale dhe të

të fundit /



Bekim Jashari përcjell mesazhin e tij pas vendimit ndaj ish-...



Marta Kos për dënimin e ish-krerëve të UÇK-së: Vendimet e Hagë...



Vllaznia kërkon reagimin në "Loro Boriçi", klubi njofton...



Aktgjykimi në Hagë, Britania apelon për qetësi dhe riafirmim...



Katër lojtarë jashtë për Ligën e Kombeve, Maran shpall të...



Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë ngre shqetësime serioze p...



Shqetësim në Frankfurt pas dy viktimitave nga malaria, hetohet...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

ndërmarrë masat e nevojshme për përgatitjen e çështjes, përmes vendimeve, urdhrave dhe udhëzimeve. Gjykatësi raportues duhet ta mbajë rregullisht të informuar panelin e Apelit, veçanërisht kur lindin kundërshtime për çështje procedurale.

Brenda 21 ditësh nga paraqitja e njoftimit për apel, kryegjykatësi ose gjykatësi raportues thërret një konferencë, në të cilën diskutohen çështjet që lidhen me ankesën.

Pala apeluese më pas duhet të paraqesë dosjen e apelit, ku përfshihen të gjitha argumentet dhe burimet ligjore që mbështesin arsyet e kundërshtimit. Afati për dorëzimin e saj është 60 ditë, ndërsa shkurtohet në 30 ditë kur ankesa lidhet vetëm me dënimin e shqiptuar.

Në vijim dorëzohet dosja e përgjigjes, përmes së cilës pala tjetër paraqet argumentet e veta juridike. Afati është 30 ditë për argumentet dhe burimet ligjore, kurse 15 ditë nëse çështja kufizohet vetëm te dënimi, duke u llogaritur nga paraqitja e dosjes. Pas saj vjen dosja e kundërpërgjigjes, për të cilën vlejnjë afate më të shkurtra: 15 ditë, përkatesisht 10 ditë kur kundërshtimi ka të bëjë vetëm me dënimin.

Pasi të përfundojnë këto afate, Gjykata e Apelit cakton datën e seancës vetëm "nëse është e nevojshme", siç thuhet në rregullore.

Gjatë procesit të apelit, palët mund të propozojnë edhe prova shtesë. Në rast se ato pranohen, palës tjetër i jepet mundësia të paraqesë kundërprova.

Kur merr vendimin, Paneli i Apelit vlerëson si materialet që tashmë gjenden në dokumentacionin e çështjes, ashtu edhe çdo provë të re të pranuar.

Me përfundimin e parashtimeve të palëve, paneli mbledhet për ta shqyrtuar çështjen dhe nxjerr aktgjykim mbi dokumentacionin e apelit dhe çdo provë shtesë të lejuar.

Gjykata e Apelit mund ta lërë në fuqi vendimin e shkallës së parë, ta anulojë ose ta ndryshojë atë, si dhe të urdhërojë zhvillimin e një rigjykimi.

Nëse apeli paraqitet vetëm nga personat e shpallur fajtorë, shkalla e Apelit nuk mund të japë një vendim më të rëndë se ai i shqiptuar në shkallën e parë.

Aktgjykimi në apel duhet të shpallet brenda 60 ditësh nga parashtimi i fundit i palëve. Mund të kërket zgjatje e këtij afati, por ajo nuk lejohet të jetë më shumë se një muaj dhe duhet të arsyetohet.

Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar njihet tri baza për apelimin e vendimeve të shkallës së parë: një gabim në një çështje juridike që e shfuqizon aktgjykimin, një gabim faktik që ka sjellë dështim të drejtësisë ose një gabim që lidhet me caktimin e dënimit.

Nëse vendimi i Apelit nuk i kënaq palët, rasti mund të dërgohet fillimisht në Gjykatën Supreme dhe më pas në Gjykatën Kushtetuese të Dhomave të Specializuara në Hagë.

Avokatët mbrojtës të ish-presidentit Hashim Thaçi kanë deklaruar se përfundimi i procesit të apelit mund të kërkojë vite.

Vendimi i trupit gjykues

Trupi gjykues i shpalli fajtorë katër ish-epororë të UÇK-së për krime lufte pas 41 muajsh nga fillimi i procesit gjyqësor, ndërsa nuk i pranoi akuzat për krime kundër njerëzimit.

Në vlerësimin e trupit gjykues, katër të akuzuarit, së bashku me drejtues të tjerë, synonin pavarësinë e Kosovës dhe krijimin e kontrollit politik e institucional në një Kosovë të pavarur.

Gjykata konstatoi se, për arritjen e këtyre synimeve, ata ndanin qëndrimin se persona të caktuar, të perceptuar si pengesë, duhej të "shënjestroheshin", "eliminoheshin" ose "neutralizoheshin".

Në këtë kategori, sipas aktgjykimit, përfshiheshin ndër të tjera anëtarë apo përfaqësues të forcave të tjera politike dhe ushtarake, sidomos individë të lidhur me Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës, persona që konsideroheshin të afërt me autoritetet serbe, si dhe pjesëtarë të komuniteteve romë dhe serbe.

Gjatë shpalljes së vendimit, trupi gjykues deklaroi se qëllimi i përbashkët ishte vënë në zbatim nëpërmjet vrasjeve, arrestimeve dhe ndalimeve pa proces të rregullt ligjor, keqtrajtimit fizik dhe psikologjik, frikësimit dhe përdorimit të asaj që aktgjykimi e përkufizon si "luftë speciale".

Sipas trupit gjykues, ish-presidenti i Kosovës Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentarët Jakup Krasniqi dhe Kadri Veseli, si dhe ish-deputeti Rexhep Selimi, dhanë kontribut në realizimin e këtij qëllimi të përbashkët.

Për Thaçin, gjykatësit vlerësuan se ai kishte rol kyç si në hartimin, ashtu edhe në zbatimin e qëllimit të përbashkët. Ata konstatuan gjithashtu se ai kishte marrë pjesë personalisht në disa krime, duke veçuar rastin e Behajdin Allaqit.

Në lidhje me Veselin, Gjykata Speciale iu referua funksionit të tij si drejtues i Drejtorisë së Zbulimit të UÇK-së. Sipas përfundimeve të trupit gjykues, ky organ ishte përgjegjës për identifikimin, mbikëqyrjen dhe neutralizimin e personave që dyshoheshin si "kolaboracionistë". Dhomat e Specializuara konstatuan se Veseli nuk kishte ndërmarrë masa për parandalimin, hetimin ose ndëshkimin e krimeve, ndonëse kishte dijeni për to.

Për Selimin, trupi gjykues arriti në përfundimin se kontributi i tij në zbatimin e qëllimit të përbashkët ishte i qenësishëm. Megjithatë, gjykata theksoi se posti i inspektorit të Përgjithshëm të UÇK-së i siguronte atij më pak autoritet mbi pjesëtarët e tjerë të UÇK-së, në krahasim me disa nga të akuzuarit e tjerë.

Sa i përket Krasniqit, i cili gjatë luftës ishte zëdhënës i UÇK-së dhe anëtar i Shtabit të Përgjithshëm, gjykata vlerësoi se ai e kishte shfrytëzuar pozitën, rolin udhëheqës, pushtetin dhe statusin e tij për të zbatuar aspektet kriminale të qëllimit të përbashkët.

Shtuar më 16.09.2026 19:00

Tags: [apelimi](#), [specialja](#), [vendimi](#)



Bekim Jashari përcjell mesazhin e tij pas vendimit ndaj ish-drejtimes të UÇK...



Marta Kos për dënimin e ish-krerëve të UÇK-së: Vendimet e Hagës duhen...



Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë ngre shqetësime serioze për aktgjykimin e...



Pas aktgjykimit në Hagë, OVL-UÇK thërret për nesër Këshillin Drejtues



Cilët janë hapat që ndërmerren për apelimin e një vendimi të Speciales



Ganimete Musliu reagon ndaj vendimit të Gjykatës Speciale



Jashari apelon për qetësi dhe maturi, kërkon zhbërjen e Gjykatës...



Protesta në Hagë, policia holandeze njofton për dy të arrestuar dhe një zyrtar t...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.